

## **Paragjykimi Mjedisor i Politikës Tregtare**

**Article by Marta Silvia Viganò**

April 14, 2022

**Pavaresisht ligjit per klimen, planit Fit for 55, tregtimin e emetimeve, dhe të gjitha ambicieve klimatike me të cilat vjen Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, BE-ja ende u ofron industrive të rënda (CO2) një subvencion të nënkuptuar për ndotjen. Si? Permes ndikimeve mjedisore ne politikat e saj tregtare; rregullimi i tregtisë ndihmon industrinë e rënda të llojëve në detaje te pa qarta pa shumë kundërshtime. Procesi krijon një subvencion global për ndotjen që peshon kundër përpjekjeve për të zbutur dhe parandaluar ndryshimet klimatike.**

Ndërsa shpejtësia e veprimit të Bashkimit Evropian për klimën është në diskutim, përpjekjet legjislative të BE-së për dekarbonizimin shtrihen prej dekadash. Vendosja e një çmimi për emetimet e karbonit është një pjesë kryesore e përpjekjeve të tilla. I miratuar për herë të parë në vitin 2005, Sistemi i Tregtisë së Emerimeve (ETS) ishte tregu i parë ndërkombëtar i karbonit në botë. Mbetet më i madhi, duke mbuluar të gjitha vendet e BE-së duke përfshirë Islandën, Lihtenshtajnin dhe Norvegjinë.

Në këtë sistem, fabrikat, termocentralet dhe impiantet e tjera blejnë ose marrin leje për tregtimin e emetimeve. Në fund të çdo viti, këto instalime duhet të heqin dorë nga ky sistem tregtie që të mbulojnë plotësisht emetimet e tyre. I shoqëruar me një kufi të caktuar për emetimet totale që zvogëlohet me kalimin e kohës, mekanizmi i detyron instalimet të reduktojnë në mënyrë progresive emetimet e tyre.

Ndërsa sistemi funksionon mirë brenda kuadrit Evropian, ai gjithashtu paraqet rrezikun e përhapjes së karbonit – domethënë që prodhimi intensiv i karbonit do të lëvizë jashtë BE-së, vetëm që prodhimi të importohet përsëri në tregun Evropian me një çmim më të ulët. Prandaj, propozimet e BE-së për një mekanizëm të rregullimit të kufirit të karbonit (CBAM) u paraqitën për herë të parë në vitin 2019.

Propozuar zyrtarisht nga Komisioni në korrik të viti 2021, CBAM do të zbatohet për sektorët e prodhimit të hekurit, çelikut, çimentos, plehrave, aluminit dhe energjisë elektrike. Një taksë mbi importet e barazvlefshme me çdo ndryshim në nivelin e taksimit të karbonit midis BE-së dhe vendeve të tjera do të sigurojë që produktet dhe importet vendase të mbeten konkurruese. Më gjerësisht, CBAM bie nën reformën e sistemit ETS. Nëse skema aktuale ETS vendos një çmim për çdo ton CO2 të emetuar nga sektorët e energjisë elektrike, aviacionit, çelikut dhe kimikateve, reforma synon ta shtrijë atë në floten detare, transportin rrugor, dhe karburantet për ngrohje. CBAM trajton gjithashtu çështjen e alokimeve falas të kredisë ETS – lejet e emetimeve të dhëna falas për industrinë e karbonit – të cilat aktualisht përfaqësojnë një subvencion të nënkuptuar për ndotjen dhe që do të hiqen gradualisht në 10 vite. Sipas skemës së propozuar rishtazi, importuesit e BE-së do të duhet të blejnë certifikata të karbonit që korrespondojnë me çmimin e karbonit që do të

ishte paguar nëse prodhimi do të bëhej në BE. Nëse një prodhues jo-BE ka paguar tashmë një taksë karboni në një vend të tretë, importuesi i BE-së mund të zbresë koston përkatëse.

Propozimi mbështetet nga sindikatat industriale. “CBAM është një domosdoshmëri për të mbajtur industrinë energjitike në Evropë, ndërkohë që dekarbonizohen. Një situatë ku të gjitha produktet e çelikut ose kimikateve prodhohen jashtë Evropës përmes industrive të karbonit do të ishte e pa vlere nga pikëpamja ekonomike, por edhe një katastrofë për mjedisin”, shpjegon Benjamin Denis nga IndustriAll. Megjithatë, ky pozicion i sindikatave pasqyron gjithashtu paqartësinë që çon në ndikimet mjedisore të politikës tregtare: shqetësimet për konkurrencën mund të shërbejnë si një bazë retorike për të lobuar kundër mjedisit.

## **Politika tregtare dhe dekarbonizimi**

Shkrimet në faqet e The Guardian, korrespondentja Jennifer Rankin; parashikoi se Plani i BE-së “propozimet e Fit per 55” do të përballen nga një “furi lobimesh” nga aktivistët, grupet e biznesit dhe vendet jo anëtare të BE-së. Ekziston një paragjykim i mëtejshëm mjedisor ndaj politikës tregtare që paketa aktuale legjislative nuk e trajton.

Le të supozojmë se mekanizmi funksionon në mënyrë perfekte. Dikush do të mendonte se stimujt për firmat tani janë në përputhje me nevojën shoqërore për të reduktuar emetimet: për sa kohë firmat paguajnë shumën e CBAM për të importuar mallra të ndotura në BE, kostot e larta do të çojnë në uljen e ofertës së mallrave të ndotura. Jo plotësisht, sepse mekanizmi mbulon vetëm majën e ajsbergut; një pjesë e konsiderueshme e kostove totale mbetet nën ujë.

Hulumtimet e bëra nga ekonomisti Joseph Shapiro tregojnë se si politika mjedisore nuk mund të përballojë kontrollin e detajuar ndaj politikës tregtare. Siç shpjegon Shapiro, tarifat e importit dhe barrierat jotarifore janë “thelbësisht më të ulëta në industrinë e ndotura sesa të pastra” në shumicën e vendeve. Industrinë më të ndotura mund të përballen me kosto më të larta të karbonit – që do të thotë se ato ndëshkohen nga politika mjedisore – por ato paguajnë më pak tarifa – që do të thotë se shpërblehen nga politika tregtare. “Ky ndryshim në politikën tregtare krijon një subvencion global të nënkuptuar për emetimet e CO2 në mallrat e tregtuara ndërkombëtarisht,” shkruan Shapiro. Ky subvencion është global sepse të gjithë partnerët tregtarë përfitojnë nga mallrat më të lira, jo vetëm nga vendi i origjinës.

### *Mekanizmi i rregullimit të kufirit të karbonit mbulon vetëm majën e ajsbergut*

Për politikën klimatike antiplumb, duhet të trajtohen stimujt e tjerë të ndotjes që vijnë nga politika tregtare. Këtu janë veçanërisht të rëndësishme barrierat jotarifore. “Njerëzit priren të fokusohen në pjesën tarifore – por pjesa më e madhe nxitet nga barrierat jotarifore”, na thotë Shapiro. Barrierat jotarifore janë kryesisht rregullatore, për shembull, cilësia e një produkti të caktuar. Atëherë mund të themi se barrierat jotarifore janë vetë burimi i këtij paragjykimi mjedisor. Lobistët i pëlqejnë barrierat jotarifore sepse, krahasuar me tarifën, ato janë më specifike, teknike dhe më të vështira për t’u analizuar. Më e keqja nga të gjitha, CBAM nuk i mbulon ato, pasi trajton vetëm diferencat në çmimin e karbonit (ose

mungesën e tij) midis BE-së dhe vendeve jo-BE. Me fjalë të tjera, ai fokusohet në tarifatat që lidhen me emetimet e një sërre gazrash, ndërkohë që kuadri më i gjerë rregullator për produktet me karbon të rëndë është jashtë tablose.

Cilat industri përfitojnë nga kjo tendence mjedisore e politikës tregtare? Të gjithë të tjerët janë njesoj, fajtorët më të mëdhenj janë ata që janë më pranë lëndëve të para dhe më larg mallrave të konsumit final; firmat që ndodhen në rrjedhën e sipërme të zinxhirit të prodhimit. Për shembull, BE-ja vendos një barrierë jotarifore për çelikun në formën e standardeve të performancës dhe cilësisë. Çeliku është një industri në rrjedhën e sipërme pasi shumë industri përdorin çelikun si një input. Skenari ideal për firmat që operojnë në rrjedhën e poshtme të zinxhirit – të gjitha industritë që përdorin çelikun si input – është që ai të jetë sa më i lirë që të jetë e mundur. Prandaj këto firma llobojnë për barrierë më të ulëta jotarifore për çelikun: me pak rregulla, standarde dhe kuota. Sa më larg të jete një produkt nga kërkesa përfundimtare, aq më e lehtë është për lobistët që të shtyjnë për ndryshime në detaje teknike që në dukje janë të vogla dhe të mërzitshme, por kanë shumë rëndësi për mjedisin.

Kjo në fund të fundit do të thotë se edhe nëse CBAM detyron shtetet jashtë BE-së të shtojnë lojën e tyre të çmimeve të karbonit, ajo është e pafuqishme përballë të gjitha barrierave jotarifore që lidhen me politikën tregtare, duke përfshirë kështu paragjykimet e saj mjedisore.

## **Lobimi mbi politikën tregtare**

Hulumtimet e Shapiro tregojnë se politika mjedisore ndërkufitare duhet të marrë parasysh në detajet e politikës tregtare përmes llogarise dhe politikës tregtare që ka më shumë rëndësi është në duart e lobistëve dhe të përqendruar në industritë e rrjedhës së sipërme. Për shkak të teknikës së njëanshmërisë tregtare, palët e interesuara mjedisore përballen me një sfidë të vështirë. Johanna Lehne e grupit të ekspertëve për ndryshimet klimatike E3G shpjegon se, ndërsa rreziqet e subvencioneve të karburanteve fosile janë kuptuar mirë, ndërgjegjësimi për çështjet tarifore dhe jotarifore është më pak i përhapur.

Të lidhura ngushtë me shkallën e ndërgjegjësimit janë sfidat me të cilat përballen OJQ-të mjedisore duke bërë që zëri i tyre të dëgjohet në nivel Evropian. Kjo mund të shpaloset në një sërë forumesh – nga kontributi tek vlerësimet e ndikimit, lobimi dypalësh, deri tek përgjigjja ndaj konsultimeve publike. Megjithatë akses i barabartë u ofrohet palëve të ndryshme të interesit, jo të gjithë aktorët kanë mjete të njëjta për të promovuar pikëpamjet dhe idetë e tyre. Ndodh shpesh që Organizatat e shoqërisë civile janë " shumë më pak të pajisura me burime të vlefshme dhe kanë më pak kapacitet për t'u angazhuar në një numër të madh dosjesh të ndryshme legjislative në krahasim me lobistët e industrisë", shpjegon Lehne. "Ka një çekuilibër pushteti."

Një aspekt tjetër ka të bëjë me atë që palët e ndryshme të interesit sjellin në tryezën Evropiane. "Si OJQ dhe organizata të shoqërisë civile, ne luajmë një rol të caktuar në sjelljen e mundësive nga publiku me i gjere. Por ajo që një lojtar i industrisë sjell në tryezë, veçanërisht rreth diskutimeve të tregut të karbonit, është një sasi e madhe të dhënash dhe njohurish specifike mbi teknologjitë përkatëse dhe shpesh komerciale", shpjegon Lehne. Komisioni Evropian është veçanërisht i interesuar të ketë akses në këtë formë informacioni.

Duke parë reformën CBAM dhe EU ETS, OJQ-te nuk janë degjuar plotësisht. “Disa lojtarë të industrisë nuk do të jenë të kënaqur me këtë përcaktim kohor. Edhe pse as OJQ-të nuk janë të kënaqura, Komisioni ka bërë një kompromis dhe ata po e njohin nevojën për të rritur presionin mbi këta sektorë,” thotë Lehne.

*Sa më larg të jete një produkt nga kërkesa  
përfundimtare, aq më e lehtë është për lobistët  
që të shtyjnë për ndryshime në detaje teknike  
që në dukje janë të vogla dhe të mërzitshme,  
por kanë shumë rëndësi për mjedisin.*

Legjislacioni i propozuar vjen me dobësi dhe pika të forta. Ajo që zakonisht konsiderohet pozitive është angazhimi për ta bërë propozimin në përputhje me ligjin e tregtisë së Organizatës Botërore të Tregtisë, për të shmangur hakmarrje të mundshme kokë më kokë. “Sigurisht, do të ketë disa paqartësi që të provohet se rrjedhja e karbonit është në të vërtetë një problem pasi nuk ka një metodologji të vendosur, ose si të hiqen kreditë pa interes për industri të caktuara. Por brenda propozimit nuk ka diskriminim të dukshëm ndaj prodhuesve jo-BE”, shpjegon Wilson. Një aspekt tjetër pozitiv është prania e një faze pilot nga viti 2023 deri në vitin 2025, e cila do t’u japë kohë partnerëve tregtarë për t’u përshtatur dhe për të lejuar bisedimet dypalëshe.

Për disa, objektivi Evropian për të reduktuar rrjedhjen e karbonit u pa si një kërkesë e padrejtë politike për të rritur ambiciet klimatike në vende të tjera. Aspiratat Evropiane të udhëheqjes klimatike mund të interpretohen si shkelje të parimit të përgjegjësisë së diferencuar të shprehur në Marrëveshjen e Parisit. “Propozimi doli në një vit që është shumë kritik për diplomacinë klimatike në nivel ndërkombëtar.” thotë Johanna Lehne.

Një çështje tjetër është ajo e mbylljes së alokimeve të emetimeve të dhëna aktualisht për firmat Evropiane. “Nëse doni të zbatoni CBAM-in, duhet të shkurtoni alokimin falas, përndryshe keni subvencione të dyfishta për industrinë ndërsa të gjithë importuesit e huaj duhet të paguajnë.” komenton Agnese Ruggiero, Carbon Market Watch. Për Lehne, propozimi ka qenë një “kompromis klasik që i bezdis të gjithë”, duke paraqitur një afat kohor 10-vjeçar me heqjen graduale të 10 për qind të shtesave falas çdo vit, ndërsa CBAM e fillon fazën e tij nga viti 2026. Nga këndvështrimi i shumë OJQ-ve klimatike, ky afat kohor është shumë i gjatë dhe do të thotë shtrirje të alokimeve falas deri në vitet 2030. “Është padyshim diçka që ne do të dëshironim ta shkurtonim, por pasja e një afati kohor i jep industrisë një shtytje dhe definitivisht përcakton drejtimin e udhëtimit”, shton Lehne.

Një pyetje tjetër që duhet adresuar është se si të perballemi me qëllimet modeste klimatike duke zhvilluar vendet nderkohe që respektohet ligji i tregtisë dhe duke hyrë në territore të paeksploruara, si në rastin e nismës vullnetare. “Le të themi, një prodhues çeliku në Rusi po operon jashtë një kuadri politikash të krahasueshme me prodhuesit në Bashkimin Evropian, por vullnetarisht merr masa për të reduktuar ndjeshëm ose në mënyrë progresive gjurmën e tij të emetimeve. A do të jene keto subjekt i rregullimit të kufirit?” pyet Wilson.

**Çfarë do të ndodhë më tej me tregëtine e gjelbërt?**

Propozimi është tani në duart e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për ta analizuar, ndryshuar dhe miratuar. Një diskutim i parë i thelluar mbi mënyrën se si do të funksiononte ky instrument u zhvillua në fillim të shtatorit dhe negociatat vazhdojnë.

Ndërsa CBAM është hapi i parë kyç për eliminimin e rrjedhjes së karbonit dhe arritjes së dekarbonizimit në nivel global, ai nuk interferon tek rregullat e ndërlikuara të politikës tregtare me stimuj të nënkuptuar për tregtimin e mallrave të ndotura. Dekarbonizimi i vërtetë dhe një formë e qëndrueshme dhe e drejtë e globalizimit dhe do të kërkojë një rivlerësim shumë më të gjerë të rregullatorëve që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare. Politikëbërësit duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje mënyrës sesi politika tregtare ndërthuret me mjedisin nëpërmjet rregulloreve dhe standardeve me cilësi të ulët ose kuotave të pabalancuara, për shembull, dhe palët e interesuara duhet të kuptojnë ndikimet mjedisore të politikës tregtare. Ndërsa reforma e qeverisjes së tregtisë ndërkombëtare është shumë e ngadaltë, këtë herë do të kemi nevojë për veprim të shpejtë.

---



Marta Silvia Viganò is a Brussels-based freelance journalist and media researcher focusing on the intersection of European policy and climate change, biodiversity, and energy. She has a background in international relations, human rights, and journalism. She can be contacted at [martasilvivigano@gmail.com](mailto:martasilvivigano@gmail.com)

Published April 14, 2022

Article in Albanian

Translation available in English

Published in the *Green European Journal*

Downloaded from <https://www.greeneuropeanjournal.eu/paragjykimi-mjedisor-i-politikes-tregtare/>

*The Green European Journal offers analysis on current affairs, political ecology and the struggle for an alternative Europe. In print and online, the journal works to create an inclusive, multilingual and independent media space. Sign up to the newsletter to receive our monthly Editor's Picks.*